SHPALLJE PUBLIKE
PËR SHPREHJE INTERESI

Në zbatim të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH", i ndryshuar, rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026, si dhe në mungesë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, të Institucionit të Avokatit të Popullit, në kuadër të ushtrimit të mandatit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen, promovimin dhe monitorimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, institucioni bën thirrje publike për shfaqe interesi "6-gjashtë Ekspertë të Jashtëm, në hartimin e Raporteve të Veçanta për Institucionin e Avokatit të Popullit", për vitin 2026.

Ekspertët e jashtëm do të hartojnë raporte tematike në fusha me interes të veçantë publik dhe institucional. Këto raporte synojnë të ofrojnë një analizë të pavarur, profesionale dhe të bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke identifikuar problematikat kryesore, sfidat ekzistuese dhe masat e nevojshme për përmirësimin e situatës në fushat përkatëse.

Secili raport përmban vlerësime, gjetje dhe rekomandime konkrete, të cilat synojnë të kontribuojnë në forcimin e politikave publike, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe rritjen e standardeve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertëve do të jenë:

- Analizimi i kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon secilën nga fushat objekt studimi;
- Vlerësimi i nivelit të respektimit, mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave në praktikë;
- Identifikimi i mangësive, sfidave dhe problematikave që ndikojnë në ushtrimin efektiv të të drejtave dhe lirive themelore;
- Vlerësimi i përputhshmërisë së legjislacionit dhe praktikave kombëtare me standardet ndërkombëtare dhe evropiane;
- Evidentimi i nevojave për përmirësimin e politikave publike dhe kuadrit rregullator;
- Hartimi i rekomandimeve konkrete, të zbatueshme dhe të orientuara drejt përmirësimit të situatës në secilën fushë;
- Mbështetja e veprimtarisë monitoruese dhe rekomanduese të Avokatit të Popullit nëpërmjet analizave të thelluara dhe evidencave profesionale.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të angazhimit pritet të arrihen këto rezultate:

- Hartimi dhe dorëzimi i pesë raporteve tematike të plota, të bazuara në analiza profesionale, legjislative dhe institucionale;
- Evidentimi i problematikave kryesore që ndikojnë në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave në fushat e trajtuara;
- Identifikimi i boshllëqeve ligjore, institucionale dhe administrative që kërkojnë ndërhyrje ose përmirësim;
- Përgatitja e rekomandimeve konkrete për institucionet publike përgjegjëse, me qëllim rritjen e efektivitetit të mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave;
- Sigurimi i një baze të qëndrueshme analitike për ndërmarrjen e iniciativave, monitorimeve dhe rekomandimeve të mëtejshme nga institucioni i Avokatit të Popullit;
- Kontributi në përmirësimin e politikave publike dhe rritjen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut;
- Rritja e ndërgjegjësimit institucional dhe publik mbi çështjet e trajtuara në raportet tematike.

Në zbatim të këtij angazhimi do të hartohen raportet e mëposhtme:

1. Raport për sigurinë në shkolla dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Raport për sigurinë publike.
3. Raport për garantimin dhe respektimin e të drejtave në fushën e sportit.
4. Raport për mbrojtjen e të drejtave mjedisore. sociale dhe ekonomike për personat në paraburgim.
5. Raport për mbrojtjen e të drejtave mjedisore.
6. Raport për komunikimin publik.

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Aplikantët duhet të ushtrojnë funksion në zbatim të legjislacionit në fuqi;
2. Aplikantët duhet të kenë në fushën e veprimtarisë, shërbimin e kërkuar;
3. Aplikantët duhet të dorëzojnë diplomë ku vërtetohet kriteri arsimor në fushën e kërkuar;
4. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacion për vërtetimin e kontratavë të ngjashme;
5. Aplikanët duhet të dorëzojnë Dëshmi Penaliteti;
6. Aplikantët duhet të dorëzojnë nr. Llog/IBAN.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës **15.10.2026, ora 16:00,** fizikisht pranë Avokatit të Popullit, me adresë Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.2, Tiranë, dokumentat e lartëpërmendur.

Pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komision i Posaçëm i ngritur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, brenda 24 orëve, do të kryejë verifikimin e plotësimit të kritereve formale të sipërcituara.

Brenda 24 orëve nga miratimit i listës paraprake, Komisioni i Posaçëm kryen procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar me qëllim vlerësimin e aftësive komunikuese e qasjes sociale të tyre, si dhe brenda 24 orëve, nga intervistimi, shpallet fituesi.

Kushtet e veçanta do të përcaktohen në Kontratë.